



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 266/7 Prot.

Tiranë, më 14.06.2022

V E N D I M

Nr.84, Datë 14.06.2022

Për një shtesë në objektin e mbikëqyrjes filluar me vendimin nr. 48 (266 prot.), datë 5.4.2022, të Komisionerit “Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë gjatë zhvillimit të procedurave të plotësimit të pozicioneve të lira në shërbimin civil nëpërmjet pranimit në shërbimin civil, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, në institucionin Bashkia Kamëz”.

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas vlerësimit të kërkeses nr. 266/3 prot., datë 30.05.2022, të paraqitur nga Drejtoria e Inspektimit dhe Hetimit Administrativ, si dhe dokumentacionit të administruar më tej gjatë këtij procesi,

Vërej se,

Me vendimin nr. 48 (266 prot.), datë 5.4.2022, të Komisionerit “Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë gjatë zhvillimit të procedurave të plotësimit të pozicioneve të lira në shërbimin civil nëpërmjet pranimit në shërbimin civil, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, në institucionin Bashkia Kamëz”, është vendosur fillimi i mbikëqyrjes për zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil në institucionin Bashkia Kamëz.

Në zbatim të Programit të Mbikëqyrjes nr. 266/1 prot., datë 5.4.2022, objekti i mbikëqyrjes përfshin zbatimin e ligjshmërisë gjatë zhvillimit të procedurave të plotësimit të pozicioneve të lira në shërbimin civil nëpërmjet pranimit në shërbimin civil, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, duke vlerësuar respektimin e kërkesave të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore përkatëse,

nga ana e subjekteve të ngarkuara prej ligjit me detyra specifike të administrimit të këtij procesi.

Procesi i grumbullimit të të dhënave në selinë e institucionit të mbikëqyrur ka filluar në datën 6.4.2022 dhe grupi i punës po vijon procesin e mbikëqyrjes sipas drejtimeve të mbikëqyrjes të miratuara në përmbajtjen e Programit të Mbikëqyrjes nr. 266/1 prot., datë 5.4.2022, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në institucionin Bashkia Kamëz.

Ndërkohë, Drejtoria e Inspektimit dhe Hetimit Administrativ, gjatë hetimit të disa informacioneve/kërkesave të ardhura nga nëpunës civilë të Bashkisë Kamëz, në përmbajtjen e të cilave janë ngritur pretendime për parregullsi të lejuara në procesin e vlerësimit të rezultateve në punë për periudhat e vlerësimit janar - qershor dhe korrik - dhjetor, të vitit 2021, ka vlerësuar se zbatimi i ligjshmërisë në realizimin e procedurave të vlerësimit të rezultateve në punë të nëpunësve civilë në këtë bashki, si në kohë ashtu dhe në cilësi, paraqet risk të veçantë. Për këtë arsye me kërkesën nr. 266/3 prot., datë 30.5.2022, *“Për zgjerimin e objektit të procesit të mbikëqyrjes që po kryhet në Bashkinë Kamëz, në bazë të vendimit nr. 48 (266 prot.), datë 5.4.2022 të Komisionerit, duke përfshirë në këtë proces dhe mënyrën e kryerjes së vlerësimit të nëpunësve civilë ekzistues dhe cilësinë e plotësimit të këtyre akteve”*, i ka propozuar Komisionerit, që të zgjerohet objekti i mbikëqyrjes që po kryhet në institucionin Bashkia Kamëz, duke përfshirë në këtë proces edhe mënyrën e funksionimit dhe zbatimit të institutit të vlerësimit të rezultateve në punë të nëpunësve civilë.

Në rrethanat si më sipër, me qëllim mbikëqyrjen e zbatimit të ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në lidhje me kryerjen e procedurave të vlerësimit të rezultateve në punë të nëpunësve civilë në institucionin Bashkia Kamëz, në zbatim të nenit 11, 90 dhe 100, të ligjit nr. 44/2015, *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”*, si dhe Rregulloren *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, të bëhet një shtesë në objektin e mbikëqyrjes që po kryhet në këtë institucion duke përfshirë në këtë proces edhe këqyrjen e procedurave të vlerësimit të rezultateve në punë të nëpunësve civilë për periudhat e vlerësimit janar - qershor dhe korrik - dhjetor, të vitit 2021.

Për këto arsye:

Bazuar në nenin 14, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar; në nenet 11, 90 dhe 100, të ligjit nr. 44/2015, *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”*; si dhe Rregulloren *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

V E N D O S A:

1. Të bëhet një shtesë në objektin e mbikëqyrjes filluar me vendimin nr. 48 (266 prot.), datë 5.4.2022, të Komisionerit *“Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë gjatë zhvillimit të procedurave të plotësimit të pozicioneve të lira në shërbimin civil nëpërmjet pranimi në shërbimin civil, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, në institucionin Bashkia Kamëz”*, duke përfshirë në objektin e kësaj mbikëqyrjeje edhe verifikimin e ligjshmërisë së procedurave të vlerësimit të rezultateve në punë të nëpunësve civilë dhe përmbajtjen e këtyre akteve, për periudhat e vlerësimit janar - qershor dhe korrik - dhjetor, të vitit 2021.
2. Për kryerjen e kësaj detyre, afati i mbikëqyrjes shtyhet edhe për 30 ditë kalendarike, tej afatit të përcaktuar në vendimin nr. 48 (266 prot.), datë 5.4.2022, të Komisionerit *“Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë gjatë zhvillimit të procedurave të plotësimit të pozicioneve të lira në shërbimin civil nëpërmjet pranimi në shërbimin civil, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, në institucionin Bashkia Kamëz”*.
3. Të njoftohet për këtë vendim Drejtorja e Përgjithshme e Mbikëqyrjes dhe Inspektimit, institucioni Bashkia Kamëz, si dhe grupi i punës.

Ky vendim hyn në fuqi menjëhere.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha